




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 28.09.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.09.2015, pas shqyrtimit të Propozimit – buxhetit Nr. 602, të datës 11.09.2015, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:


V E N D I M

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2016 në total prej 8,578,620.00€, i shpërndarë nëpër kodet e programeve dhe nën-programeve të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 720 të punësuar në Administratë, Arsim dhe Shëndetësi është 4,288,461.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime është 564,245.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunalë është 150,000.00€;
 - 1.4 Për subvencione dhe transfere është 274,675.00€;
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale është 3,301,239.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 29.09.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.09.2015, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 577, të datës 04.09.2015, paraqitur nga Drejtoria për Financa dhe Buxhet, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, në shumë të përgjithshme prej 3,187,405.15€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër njësitë buxhetore ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Në Administratë buxheti i shpenzuar është 1,186,146.73€,
 - 2.2 Në Arsime buxheti i shpenzuar është 1,443,615.39€,
 - 2.3 Në Shëndetësi buxheti i shpenzuar është 543,963.88€ dhe
 - 2.4 Në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim buxheti i shpenzuar është 13,679.15€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa dhe Buxhet.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FB dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Nr./No. 127
Data/Datum 12. 10. 2015
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 09.10.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.09.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 874, të datës 18.08.2015, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, në lidhje me kërkesën Nr. 05-350-15625 të datës 23.06.2015, të paraqitur nga sh.p.k "Kosmonte Foods", prej palës Lulzim Begaj, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës. Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 874 i datës 18.08.2015, për ndërrimin e destinimit të sipërfaqes prej 2.00ha, nga ngastra kadastrale Nr. P-72514003-00022-3, në zonën kadastrale Harilaç, në vendin e quajtur 'Shuma Pod Golesh' e evidentuar sipas certifikatës Nr. 25-4275, P.Sh. Pylltaria, nga zona gjelbëruese pyjore në zonë ndërtimore, me destinim për lejin e ndërtimit të përkohshëm montazhë të objekteve, (objekti kryesor me sipërfaqe totale depoja me komora për ftohje S=5544m², objekti për administratën me etazhitet P+1 në sipërfaqe prej S=2210m², stacioni për derivate të naftës, servisi me autolarje dhe hapësira për parking), për Sh.p.k-në 'Kosmonte Foods', pronar Lulzim Begaj.
2. Ndërtimi i objekteve të përkohshme montazhë, lejohet në përputhje me pëlqimin e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Nr. APK-DP 487/15, të datës 17.06.2015, kontratën me Ref: APK-DP 488/15, të datës 17.06.2015, për periudhën pesë vjeçare deri më datën 17.06.2020 dhe vendimin nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës me Nr. 02-4 të datës 30.07.2015.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave të ndërtimit dhe procedurave tjera, është në kompetencë të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Drejtorisë për Inspektorat
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditë e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë për BZHR, Drejtorisë së INSPK, Palës dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi